



Nr. / 02-1377/h
04.06 2026
Universiteti i Tetovës
Универзитет во Тетово
Rektorat, rr. BindeMit, p/b
Ректорат, ул. БиндеМит, п/б
551200, Tetovë/Tetovo

UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

INFORMATË

e votimit të realizuar për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës për mandatin

2026 — 2029

Pas pranimit të rezultateve nga votimi i zhvilluar në njësitë për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2026–2029, të dorëzuara veçmas nga komisionet zgjedhore të njësive të Universitetit, Komisioni Universitar i Zgjedhjeve bëri përmbledhjen e rezultateve të votimit të realizuar në të gjitha njësitë përbërëse të Universitetit.

Më 04.06.2026, nga ora 12:00 deri në orën 14:00, u realizua votimi i fshehtë.

Votimet u realizuan në 13 fakultete brenda Universitetit për kandidatët e mëposhtëm për rektor:

1. **Fehari Ramadani**, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik
2. **Jusuf Zejneli**, profesor ordinar në Fakultetin Juridik
3. **Kushtrim Ahmeti**, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik

Votimi filloi dhe mbaroi në orën e caktuar në të gjitha njësitë.

Bazuar në raportet dhe procesverbalet e dorëzuara nga komisionet zgjedhore të njësive për zgjedhjet e mbajtura, konstatohet se nuk janë gjetur parregullsi ose ndonjë problem tjetër, përkatësisht votimi është zhvilluar tërësisht në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Udhëzuesin për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2026 - 2029.

Në bazë të listave zgjedhore të njësive të Universitetit, janë regjistruar gjithsej 355 votues.

Në ditën e votimit për zgjedhjen e rektorit votuan gjithsej 343 anëtarë të këshillave mësimorë-shkencorë të njësive.

Gjithsej 12 fletëvotime kanë mbetur të papërdorura

Rezultatet e votimit të shprehura në pikë të fituara nga secili kandidat për zgjedhjen e rektorit

Nr. rend	Njësia e UT-së (Fakulteti/instituti)	Kandidati për rektor, prof. dr. Fehari Ramadani Pikë të fituara	Kandidati për rektor, prof. dr. Jusuf Zejneli Pikë të fituara	Kandidati për rektor, prof. dr. Kushtrim Ahmeti Pikë të fituara
1.	Fakulteti Ekonomik	10	1	24
2.	Fakulteti Juridik	21	1	15
3.	Fakulteti Filozofik	7	0	23
4.	Fakulteti Filologjik	16	3	16
5.	Fakulteti Pedagogjik	8	1	13
6.	Fakulteti i Mjekësisë	18	2	21
7.	Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore	10	9	36
8.	Fakulteti i Shkencave të Zbatuara	5	0	8
9.	Fakulteti i Kulturës Fizike	4	0	13
10.	Fakulteti i Administrimit të	1	0	4

	Biznesit			
11.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit	2	1	7
12.	Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë	1	0	9
13.	Fakulteti i Arteve	16	4	8

Nga rezultatet e paraqitura konstatohet gjendja faktike si vijon:

1. Kandidati për rektor **Fehari Ramadani**, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, fitoi gjithsej 843.915 pikë.
2. Kandidati për rektor **Jusuf Zejneli**, profesor ordinar në Fakultetin Juridik, fitoi gjithsej 128.408 pikë.
3. Kandidati për rektor **Kushtrim Ahmeti**, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, fitoi gjithsej 1627.677 pikë.

Në përputhje me nenin 106, paragrafi 9 të Statutit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2026–2029, për rektor të Universitetit të Tetovës është zgjedhur kandidati: **Kushtrim Ahmeti**, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, me numrin më të madh të pikëve të fituara.

Tetovë, 04.06.2026.

Kryetari i Komisionit Universitar të Zgjedhjeve

prof. dr. Metin Izeti



(Emri dhe mbiemri, nënshkrimi)